



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 29 datë 24.03. 2026

“PËR PRANIM NË SHTËPINË E TË MOSHUARVE GJIROKASTËR”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore “, pikës 6 të nenit nr 28 të Ligjit nr 9355, date 10.03.2005”Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”i ndryshuar, VKM-së nr 209, date 12.04.2006 dhe Udhëzimit nr 2470, date 26.12.2006, VKM-së nr 425, date 27.06.2012”Për përcaktimin e kriterëve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, VKM Nr 839 datë 03.12.2014”Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr 425 datë 27.06.2012 ”Për kriteret e vendosjes në institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror dhe dokumentacionin e nevojshëm për pranim” dhe kërkesën nr.4 prot datë 18.03.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1.Të miratojë kërkesën e paraqitur nga Administratori i Njesisë Administrative Frashër Z.Maringlen Spahiu.

-Zj.Lumturi Tako me vendbanim në fshatin Koblarë, Njësia Administrative Frashër, Përmet, për t’iu dhënë e drejta e kalimit në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër për strehim si banor i Bashkisë Përmet, Qarku Gjirokastër .

2.Kërkohet për Zj.Lumturi Tako strehim dhe përkujdesje nga ky institucion pasi është e braktisur nga familja dhe në kushte ekonomike shumë të vështira .

3.Dokumentacioni të kajojë në Shtëpinë e të moshuarve Gjirokastër.

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Aleks TANE

Në mungesë dhe me porosi

Nënkryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet

Agim ANDONI

